



*KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.*

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a.

Procedura për llogaritjen e humbjeve nga stoqet e ngadalshme dhe te vjetruara

Procedura për llogaritjen e humbjeve nga stoqet e ngadalshme dhe te vjetruara

Hyrje

Qëllimi i kësaj procedure është të përcaktojë trajtimin kontabël për inventarët e vjetruar dhe me qarkullim te ngadalshëm. Një çështje kryesore në kontabilitetin për inventarët është shuma e kostos që duhet të njihet si një aktiv dhe të mbartet deri në njohjen e të ardhurave përkatëse. Kjo procedure përcakton njohjen e mëpasshme të saj si një shpenzim si pasoj e zhvlerësimit apo dëmtimit deri në vlerën neto të realizueshme.

Qëllimi i provizionimit të stoqeve dhe inventarit të imët është të arrihet deri tek matja e saktë e zhvlerësimit të vlerës së mbajtur të stoqeve ne përputhje me Standardin Ndërkombëtar te Kontabilitetit 2, Stoqet.

Objekti

Kjo procedure zbatohet për të gjithë inventarët, me përjashtim të:

- (a) rezervave te thëngjillit dhe
- (b) Derivatet e naftës, mazutit etj.

Zhvlerësimi i inventarit

Praktika e zhvlerësimit të inventarëve poshtë kostos deri në vlerën neto të realizueshme është në koherencë me pikëpamjen që aktivet nuk duhet të mbahen me shuma mbi ato që pritet të realizohen nga shitja apo përdorimi i tyre.

Llogaritja e zhvlerësimit te inventarit do te behet për një grup te artikujve te lidhur ose të ngjashëm. I tillë mund të jetë rasti i artikujve të inventarit të cilët i përkasin të njëjtës linje produkti, kanë qëllime apo përdorime përfundimtare të ngjashme, janë prodhuar e tregtuar në të njëjtën zonë gjeografike dhe praktikisht nuk mund të vlerësohen veças elementëve të tjerë në atë linjë produkti.

Në çdo periudhë të mëpasshme bëhet një vlerësim i ri i vlerës neto të inventarit. Kur rrethanat të cilat çuan në zhvlerësimin e inventarëve poshtë kostos nuk ekzistojnë më, ose kur ka evidencë të qartë të rritjes së vlerës neto të inventarit për shkak të rrethanave ekonomike të ndryshuara, qarkullimit apo

futjes ne përdorim te tyre, shuma e zhvlerësimit rimerret (që do të thotë se kjo rimarrje kufizohet deri në shumën e zhvlerësimit fillestar), kështu që vlera kontabël është më ulëta midis kostos dhe vlerës neto të

Procedura për llogaritjen e humbjeve nga stoqet e ngadalshme dhe te vjetruara

rishikuar. Kjo ndodh për shembull, kur një element i inventarit, që është zhvlerësuar për shkak të qarkullimit të tij të ngadalshëm futet pastaj në përdorim.

Kalkulimi i zhvlerësimit të inventarit

Llogaritja e humbjeve të shkaktuara nga qarkullimi i ngadalësuar apo vjetërsia e inventarit do të bëhet sipas metodës më poshtë:

Vjetërsia	Humbja e aplikuar
------------------	--------------------------

Mbi 100 ditë	80%
--------------	-----

Shlyerja e inventarit të zhvlerësuar

Inventari i zhvlerësuar do shlyhet nga librat kontabël pasi të merret aprovimi i komisionit qendror për numërim fizik se i njëjti me nuk mundet të përdoret dhe duhet të hedhet apo shitet për skrap.

Lista e inventarit të propozuar për shlyerje dërgohet për aprovim tek bordi i drejtoreve.

Data e hyrjes në fuqi

Kompania obligohet të zbatojë këtë procedurë për pasqyrat financiare për periudhat vjetore që fillojnë pas datës 1 janar 2019 e në vijim.



KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.

15-04-2020

Nr. 1549

PRISHTINË-A

Bordi i Drejtorëve i Korporatës Energjetike të Kosovës Sh.A.

Ne mbështetje të dispozitave nga Rregulloret e ndërmarrjes, neni 4 i kreut III, që rregullon të drejtat dhe përgjegjësitë e tij, dhe duke vepruar konform dispozitave aty përkitazi me vendimmarrjen jashtë takimit dhe sipas regjistrimit të rregullt nga Sekretari, Bordi i Drejtorëve me dt. 17 mars 2020, ka vendosur si me poshtë:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS PËR LLOGARITJEN E HUMBJEVE NGA STOQET E NGADALSHME DHE TE VJETRUARA

Ne pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tij për udhëheqjen e ndërmarrjes, si dhe Pasi ka pranuar rekomandimin e njëjtë nga Komisioni i Auditimit i Bordit të Drejtorëve, Bordi i Drejtorëve miraton Procedurën për llogaritjen e humbjeve nga stoqet e ngadalshme dhe te vjetruara, si është prezantuar.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i Drejtorëve.

Shtojce: *Procedura për llogaritjen e humbjeve nga stoqet e ngadalshme dhe te vjetruara, versioni i miratuar*

Zt. Faruk Hajri
Kryesues



Datë
18 mars 2020